


Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Matematika që po nisim të studiojmë këtë vit është vërtet interesante. Mos u shqetësoni – matematika është më shumë se thjesht mbledhje e zbritje numrash. Jo më kot është quajtur “shkenca e rregullsive”! Aftësitë për të dalluar dhe për të përshkruar rregullsitë si dhe për të bërë parashikime në bazë të këtyre rregullsive, janë të rëndësishme në matematikë.

Do të nisim duke kërkuar rregullsitë në trekëndëshin e Paskalit, një trekëndësh numrash që përmban rregullsi të shumta.



A mund të përshkruani ndonjë rregullsi në këtë trekëndësh? Përpiquni të parashikoni numrat në radhën vijuese në tabelë. Mos u shqetësoni nëse akoma nuk gjeni ndonjë rregull. Gjatë ditëve të ardhshme do të mësojmë shumë gjëra për këtë trekëndësh.

Do të kërkojmë gjithashtu rregullsi të formës. Për shembull, sipërfaqja e një hoje mjalti, si ajo që tregohet këtu në sfond, përbëhet nga gjashtëkëndësha që përputhen së bashku pa u mbivendosur. A mund të krijoni një rregullsi të tillë me katrorë? Po me trekëndësha?

Fjalor Gjatë kësaj kohe, do të mësoni këto fjalë të reja:

kënd
shumëkëndësh konkav
simetri vijore
radha e veprimeve
shumëkëndësh

shumëkëndësh i rregullt
sekuencë
term
mosbarazi e trekëndëshave
kulm

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Gjatë javëve të ardhshme, nxënësi mund të tregojë interes për rregullsitë dhe rregullat. Kërkojini të sjellë shembuj rregullsish dhe rregullash, të tilla si mënyra për të llogaritur përafërsisht distancën nga pika ku ka rënë rrufeja (në milje): *duke numëruar sa sekonda kalojnë nga momenti kur shohim vetëtimën deri kur dëgjojmë bubullimën, dhe pastaj duke e pjesëtuar rezultatin me 5.*

